# DËSHMI ARKIVI

**A-440632**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kriza e pagave të drejtësisë, Rama sulmon KLP dhe KLGj: Pavarësia ka rrëshqitur në papërgjegjshmëri - Informohu siç duhet |
| ADRESA | `https://radar.al/kriza-e-pagave-te-drejtesise-rama-sulmon-klp-dhe-klgj-pavaresia-ka-rreshqitur-ne-papergjegjshmeri/` |
| BURIMI | radar.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 18:59:10 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 09:29:38 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5ffdec554167e8d12a75c7f86946a01d6c55b9999b3276754bc4045bb9390671` |
| TEKSTI | `e8777d40d2f38d4c4af9e508ec65b5afb3564a0268bdad00e3cd3d9192a3ecf5` |
| PAMJA | `8364c74bac8219973946e202dda70d016e670a29386679286b1899a612b081f3` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b056e6eeed46bc102e1f979509c4b56442e7b63bac2fc64629aa553b8e09877d` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b056e6eeed46bc102e1f979509c4b56442e7b63bac2fc64629aa553b8e09877d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POLITIKE

# Kriza e pagave të drejtësisë, Rama sulmon KLP dhe KLGj: Pavarësia ka rrëshqitur në papërgjegjshmëri

SEPTEMBER 13, 2026



Kryeministri Edi Rama ka reaguar sërish për debatin mbi pagat e gjyqësorit, duke e cilësuar tepër shqetësuese atmosferën e krijuar. Rama thotë se pavarësia e gjyqësorit ka rrëshqitur në papërgjegjshmëri dhe kritikon Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP) dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGj) për mënyrën se si kanë vepruar lidhur me pagat.

Sipas kryeministrit, burimi i konfliktit është vendimi që këto struktura morën për pagat e gjyqësorit, duke kërkuar që Thesari i Shtetit të mundësojë zbatimin e tij.

> "Dy shëmbëlltyrat e anës së errët të medaljes së reformës në drejtësi, dy trupa të mbingarkuara me njerëz, paga, shpenzime, por me një produktivitet që lë shumë për të dëshiruar në aspektin e misionit që kanë si trupa qeverisëse të sistemit të drejtësisë që është i pavarur, jo më në letër, por në realitetin faktik të Shqipërisë ku pavarësia aq sa ka sjellë të mira, aq edhe ka sjellë sfidën e madhe të rrëshqitjes në papërgjegjshmëri, por nuk dua të hyj në këtë temë. Është temë komplekse, është e duhura, koha në dispozicion për të transformuar rrënjësisht dhe ngritur një sistem drejtësie, ka qenë e shkurtër sepse këto janë ndryshime epokale dhe ky ndryshim epokal ka nisur.

> Dua të them vetëm sesa shqetësuese, sa e shëmtuar, sa vulgare është atmosfera e krijuar nga një konflikt pushtetesh dhe nga një barrikadim i atij pushteti të pavarur, kushtetues që duhet të garantojë barazinë para ligjit për të gjithë e mbi të gjitha mbi vetveten, e mbi të gjitha përtej gërmës së ligjit të garantojë një shembull. Kur vjen puna që del nga salla e gjyqit dhe është i organizuar në shoqata për t'i dhënë zë shqetësimeve të trupës në publik. Këtu flasim për një tjetër dimension dhe është i rëndësishëm për shembullin që jepet. Janë një palë që kanë këtë interes."

Rama u ndal më tej te KLP dhe KLGj, duke i cilësuar si dy struktura drejtuese të sistemit të drejtësisë dhe duke ngritur pikëpyetje mbi mënyrën se si është marrë vendimi për pagat.

> "Dua ta nis aty ku e fillova, te këto dy trupa këshillash, dy maja, një majë me dy trupa të piramidës së gjyqësorit. Këta burra dhe gra që paguhen jo pak dhe që janë aty për të administruar punët e gjyqësorit, jo për të bërë drejtësi, për të administruar proceset që deri dje i administronte kuvendi, politika dhe tani janë në

Demo

Postimet e reja

Zjarri në Valare të Gjirokastrës, flakët...
SEPTEMBER 13, 2026

Rama reagon ndaj gjyqtarit të GJKKO: E...
SEPTEMBER 13, 2026

Droni rus godet trenin në Ukrainë, pak minuta më...
SEPTEMBER 13, 2026

Trump paralajmëron Zelenskyn: Ndaloni sulm...
SEPTEMBER 13, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 8, 2026

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka bërë thirrje për konsumatorët që kanë blerë një produkt sallami...

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe "problematikët"

Beralb fitoi 15 mln euro nga bakri shqiptar, por po helmon fshatra të tërë me ndotje

LISTAT E DELINËS/ Granti për startup-et riciklon fituesit, 15 emra morën para edhe në vitin 2025

Na ndiq

Facebook Instagram
YouTube TikTok

pavarësinë e tyre të plotë. Si mundet që gjëja e parë që bëmë u kuturisëm të marrim një vendim në mes të verës dhe të nxjerrim një urdhër që është zanafilla e këtij konflikti, pagat janë këto dhe Thesari i Shtetit të hapë derën. Le të themi se kanë të drejtë, por le të themi, kjo është mënyra, rruga, shembulli, këtë ju mësojmë ne, të tërë së bashku, njerëzit e drejtësisë, qytetarëve shqiptarë? Kështu kërkohet e drejta? Në mënyrë të njëanshme? Pa ezauruar asnjë nga hapat e tjerë? ne jemi përfaqësues apo 3 shtete në konflikt? Çfarë është Shqipëria? Çfarë janë këto pushtete? Çfarë ndodh këtu? Si është e mundur që nuk hidhet hapi i parë normal? Kërkohet një kontakt, ulet njeriu në tavolinë, njerëzit që jetojnë me përgjegjësinë e një shteti", shprehet kryeministri.

Edi rama gjyqesori paga

SHARE.

**RRETH NESH**

Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

**NIPT:** M47705501A
**Email:** radarlajme@gmail.com
**Kontakt:** +355689008000

**HOROSKOPI**

**Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator**

**Një ditë me surpriza në dashuri: Horoskopi për të gjitha shenjat**

**Pak dramë, shumë ndjenja: Horoskopi i dashurisë për këtë javë**

Aleanca për Media Etike
Artikull joetik?
raporto këtu

© Radar.al. dizenjuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.